

Research Article

Business Models for Albanian Farms

Brikenë DIONIZI ^{1*}, Donika KËRÇINI²

¹University of Shkodra “Luigj Gurakuqi”, brikene.dionizi@unishk.edu.al

²Agricultural University of Tirana, dkercini@ubt.edu.al

Abstract

The business model is a new concept already. It began to be studied in the early 1990s, is widely mentioned but little analyzed (Teece, 2010). A business model describes how business creates value in the market (Chesbrough, 2010). But today businesses and society as a whole are required to implement sustainability, which has at its core the creation of values not only economic but also social and environmental. It is with this in mind that this paper attempts to analyze the concept of sustainability in a business model applicable to Albanian farms. Why in agriculture? Because agriculture is a strategic sector for our country, it contributes 18.39% to GDP with an annual growth of 0.63% (INSTAT, 2019). In 2019 the real annual growth is the lowest in the last 6 years. This shows that agriculture is not functioning at the maximum capacity that our country has. Furthermore, Albania has joined other countries in its commitment to SGDs (Sustainable Development Goals) and given that sustainability in agriculture plays a significant role in most of the 17 Objectives, it is important to talk about models of stable to be applied on Albanian farms. Therefore, the paper should be considered by researchers (for further study), farmers (for application) and policy makers (so that policies have the right direction to have the greatest impact on the future of the community and the community.). This paper presents the Canvas triple model adapted for farm use.

Keywords: Business model, sustainability, agriculture

JEL Codes: Q01

* Corresponding Author

Accepted for publication December 2021

Modelet e Biznesit për Fermat Shqiptare

Brikenë DIONIZI ^{1†}, Donika KËRÇINI²

¹*Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, brikene.dionizi@unishk.edu.al

²Universiteti Bujqësor i Tiranës, dkercini@ubt.edu.al

Abstrakt

Modeli i biznesit është një koncept jo i ri tashmë. Ai ka filluar të studjohet në fillimet e viteve 1990, përmendet shumë por analizohet pak (Teece, 2010). Një model biznesi përshkruan sesi biznesi krijon vlerë në treg (Chesbrough, 2010). Por sot nga bizneset e shoqëria e tërë kërkohet të zbatohet qëndrueshmëria, e cila ka në thelb të saj krijimin e vlerave jo vetëm ekonomike por edhe ato sociale e mjedisore. Pikërisht me këtë këndvështrim ky punim përpaket të analizojë konceptin e qëndrueshmërisë në një model biznesi të aplikueshëm për fermat shqiptare. Pse në bujqësi? Sepse bujqësia është një sektor strategjik për vendin tonë, ajo kontribon 18.39% në PBB me një rritje vjetore 0.63% (INSTAT, 2019). Në vitin 2019 rritja reale vjetore është më e ulta në 6 vitet e fundit. Kjo tregon që bujqësia nuk po funksionon në maksimumin e kapacitetit që ka vendi ynë, gjë që kërkon një ndërhyrje dhe qëndrueshmëria mund të jetë një praktikë për t'u përqafuar pasi qëndrueshmëria në bujqësi kërkon të rrisë të ardhurat e fermave duke mbrojtur mjedisin dhe përmirësuar cilësinë e jetës së familjeve të fermerëve dhe të komunitetit përreth. Për më tepër Shqipëria i është bashkuar vendeve të tjera në angazhimin për SGD-të (Sustainable Development Goals) dhe duke qenë se qëndrueshmëria në bujqësi luan një rol të konsiderueshëm në pjesën më të madhe të 17 Objektivave, është e rëndësishme të flitet për modele të qëndrueshme për t'u aplikuar në fermat shqiptare. Prandaj dhe punimi duhet të konsiderohet nga studjuesit (për studim të mëtejshëm), nga fermerët (për aplikim) e nga politikëbërësit (në mënyrë që politikën të kenë drejtimin e duhur për të patur sa më tepër impakt në të tashmen e në të ardhmen e komunitetit). Në këtë punim paraqitet modeli i trefishtë Canvas i përshtatur për përdorim në fermë. Në këtë përshtatje shihet se modeli i jep mundësi përdoruesit jo vetëm për të konkretizuar aktivitetin e tij brenda konceptit të qëndrueshmërisë.

Fjalë kyç: Model biznesi, qëndrueshmëri, bujqësi

JEL Codes: Q01

[†] Corresponding Author

Accepted for publication December 2021

Hyrje

Shqipëria është një vend kryesisht malor ku 42% e tokës përdoret për bujqësi (FAO, 2016). Janë disa kultura që kanë pësuar rritje në prodhim si perimet dhe foragjeret (INSTAT, 2020), megjithatë një sipërfaqe e ulët për kultivim dhe produktiviteti i ulët mbeten pengesë për një rritje të qëndrueshme ndërkohë që Shqipëria vazhdon të importojë sasi të konsiderueshme të produkteve bujqësore e ushqimore (INSTAT, 2020). Duke pasur parasysh potencialet e vendit, bujqësia duhet të ketë një performancë shumë më të mirë. Fermerët shqiptarë janë kryesisht të vegjël dhe mundësia e tyre për të aksesuar teknologjitë e fundit është shumë e vogël. Prandaj dhe një strategji shumë e mirë për t'u ndjekur do ishte orientimi drejt praktikave të qëndrueshme në bujqësi. Qëllimi i këtij punimi është të identifikohet rëndësia e modelit të qëndrueshëm të biznesit dhe të vlerësohet mundësia për t'u aplikuar në fermat shqiptare. Objektivat e këtij punimi janë si më poshtë:

- ✓ Të paraqitet koncepti i modelit të njësisë së biznesit
- ✓ Të bëhet një prezantim i modeleve të qëndrueshme
- ✓ Të jepet informacion mbi praktikën e qëndrueshme të biznesit në bujqësi
- ✓ Të paraqiten mundësitë që ofron aplikimi i modelit të qëndrueshëm në fermat shqiptare

Punimi është një thellim teorik bazuar në burime dytësore informacioni. Duke qenë se bujqësia është një sektor kyç i ekonomisë së vendit, por aktualisht nuk po shfrytëzohen potencialet, qëllimi është të vëzhgohet e të vlerësohen mundësitë që japin studimet e bëra. Disa studime të marra në konsideratë në këtë punim, të realizuara në vende të zhvilluara me potenciale të ngjashme me vendin tonë tregojnë se mjaft mirë mund të zbatohen konceptet e qëndrueshmërisë. Një element i rëndësishëm që duhet të përmirësohet është niveli i njohurive të fermerëve. Të mësuarit do i bënte fermerët të ndërgjegjësohen, të mësojnë e të zbatojnë praktikën e qëndrueshme. Duke qenë se fermat janë kryesisht të vogla dhe fokusi është vetëm në qëllimin ekonomik (fermat mezi arrijnë të plotësojnë nevojat vetjake dhe një sasi e vogël e prodhimit tepron për t'u shitur në treg) është pak e vështirë të zhvendosësh vëmendjen e fermerëve te qëllimi mjedisor e social (ku synojnë praktikën e qëndrueshme). Prandaj dhe duhet të modelohen praktika të mësuarit që vënë theksin e duhur tek përfitimet që kanë fermerët e vegjël po të përqafojnë praktikën e qëndrueshme. Një moment shumë i rëndësishëm në biznes është planifikimi prandaj dhe është thelbësor që të studjohet terreni, të vlerësohen praktikën më të mira dhe të konsiderohet mundësia e aplikimit të këtyre praktikave në realitetin shqiptar. Sigurisht mbetet kufizim i këtij studimi aplikimi praktik që mjaft mirë mund të jetë një mundësi për të vazhduar e për të thelluar studimin në këtë drejtim.

Modelet e biznesit, sfondi teorik

Në një treg gjithnjë e më të madh, në një botë gjithnjë e më dinamike, inovacioni është fjala më e përdorur. Inovacioni nuk është thjesht një ide e re, por një proces i tërë që po të bëhet siç duhet do të sjellë vlerë për biznesin. Kur mendojmë për inovacionin duhet të zgjerojmë këndvështrimin, nuk e kemi fjalën këtu thjesht për ofrimin e produkteve apo shërbimeve të reja. Shumë kompani edhe pse kanë nxjerrë produkte apo teknologji të reja, nuk kanë qëndruar për shumë gjatë në treg. Inovacioni është krijimi i mënyrave të reja apo përmirësimi i tyre për të siguruar vlerë për biznesin (Bessant&Tidd, 2018). Inovacioni duhet të mendohet edhe në këndvështrimin e modelit të biznesit. Nëse bizneset nuk përshtasin modelin e tyre sipas risive që ndodhin në treg, atëherë jetëgjatësia e tyre nuk do shkojë gjatë në kohë (Gassmann etj, 2013). Por, çfarë është një model njësie biznesi? Modeli i njësisë është një model që tregon sesi një biznes krijon, siguron dhe mban vlerë për konsumatorët dhe grupet e tjera të interesit (Baden-Fuller&Morgan, 2010). Përdorimi i modelit si koncept është i rëndësishëm pasi

- ✓ jep një orientim për inovacionin që të sigurojë e ruajë vlerë
- ✓ siguron një mënyrë për të ndarë ide me të tjerët dhe
- ✓ siguron një listë të elementeve të domosdoshme për t'u realizuar në mënyrë që biznesi të jetë i suksesshëm.

Përsa i përket kërkimeve të realizuara lidhur me modelet e biznesit, ata kanë filluar relativisht vonë (duke pasur parasysh studimet në fushën e ekonomisë), pas viteve 1990. Modeli i biznesit është një koncept gjithëpërfshirës që dallon komponentët përbërës të një biznesi dhe i vendos së bashku si një i tërë (Demil&Lecocq, 2010; Osterwalder&Pigneur, 2010). Dimensionet bazë të një modeli biznesi (Osterwalder 2004) janë:

- ✓ **Kush?** – Kush është konsumatori? Dështimi në përcaktimin e qartë mund të çojë në dështim të sipërmarrjes.
- ✓ **Çfarë?** – Çfarë i ofrohet konsumatorit? Këtu përfshihet tërësia e produkteve/shërbimeve që kanë vlerë për konsumatorin
- ✓ **Si?** – Biznesi duhet të zotërojë disa procese e aktivitete që të gjitha së bashku me burimet e përfshira, aftësitë dhe organizimin e tyre në zinxhirin e brendshëm të vlerave të biznesit, përbëjnë dimensionin e tretë dhe
- ✓ **Vlera** – Dimensionin e katërt që shpjegon pse modeli është i zbatueshëm nga ana financiare.

Duke iu përgjigjur pyetjeve të mësipërme, modeli bëhet i prekshëm. Ideja e modelit të biznesit konsiderohet si një ide e rëndësishme për përmirësimin e performancës së përgjithshme të biznesit (Sinfield etj, 2012; Baden-Fuller&Morgan, 2010).




Figura 1. Elementet e një modeli njësie biznesi

Metodat dhe procedurat

Bujqësia ka qenë dhe mbetet një sektor kyç për ekonominë shqiptare (INSTAT, 2020). Sipas FAO (2018) 74% e fermave të vogla familjare kanë burime shumë të kufizuara me një zotërim mesatar jo më shumë se 0.5 ha, por që siguron pjesën më të madhe të prodhimit bujqësor që furnizon tregun vendas dhe më gjërë. Burimet e kufizuara nuk duhet të kufizojnë dhe mundësitë e fermerëve dhe aplikimi i qëndrueshmërisë në ferma është një strategji për të maksimizuar përfitimin. Nëpërmjet rishikimit të literaturës paraqitet modeli i qëndrueshëm i biznesit, lehtësia e orientimit të fermerit (në rastin tonë) në aplikimin e tij dhe mundësitë që të ofron përqaftimi i qëndrueshmërisë në njësinë e biznesit (në fermë në rastin tonë).

Pse është zgjedhur kjo metodologji në rastin konkret? Qëndrueshmëria nuk është një koncept i ri tashmë në Shqipëri. Vendi ynë i angazhuar në realizimin e SDG-ve ka filluar të ndërmarrë hapa në këtë drejtim. Deri më tani janë vlerësuar objektivat të cilat i përkasin Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (9 në 17 objektiva) dhe është theksuar rëndësia e matësave të këtyre objektivave. Ndërkohë që qeveria punon për politikat mbi qëndrueshmërinë, është e rëndësishme që fermerët të kapin tregun dhe për këtë ata duhet të rrisin produktivitetin. Modeli i qëndrueshëm është një model i përshtatshëm për t'u përdorur në këtë drejtim. Çështja qëndron që ky model është përdorur në bizneset jobujqësore, ndërkohë që në këtë punim po paraqitet një ridimensionim i modelit (për përdorim në fermë). Duke qenë se aktualisht nuk është e mundur të gjenden mjaftueshëm të dhëna në terren lidhur me zbatimin e modelit,

punimi mbetet në sfodin teorik, për t'u ndjekur me studime të mëtejshme për aplikim në praktikë dhe ofrimin e rasteve të mirëfillta studimore.


Qëndrueshmëria në modelet e biznesit

Sot konkurrueshmëria nuk arrihet vetëm me ofrimin e produkteve e shërbimeve të reja, por me inovacionet që firmat realizojnë në modelin e tyre. Mënyra sesi ata bëjnë biznes, fleksibiliteti me të cilin përqafojnë ndryshimet në mjedisin e jashtëm, bëjnë që bizneset të qëndrojnë në treg e të mbajnë avantazhin e tyre konkurrues. Qëndrueshmëria është një koncept që po merr gjithnjë e më tepër vëmendje. Kjo ka detyruar njësitë e biznesit që të rishikojnë modelet e tyre dhe të bëjnë modifikimet përkatëse për t'u orientuar drejt qëndrueshmërisë, duke i dhënë rëndësi përfshirjes së shumë grupeve të interesit dhe krijimit të vlerave përtej atyre ekonomike (Bocken etj, 2013; Wells, 2016; Weber&Kratzer, 2013). Breuer etj (2013) në studimin e tyre për modelet e biznesit të orientuar nga qëndrueshmëria, pas një studimi të hollësishëm të literaturës propozojnë disa parime për t'i orientuar modelet e tyre drejt qëndrueshmërisë. Kështu parimet janë:

- *Orientim drejt qëndrueshmërisë* – ky është një parim kyç për këto modele. Këtu përfshihen aspekte normative (siç është psh lehtësimi i ndikimit mjedisor) dhe praktika menaxheriale bazuar në vlera.
- *Krijimi i vlerave të zgjeruara* – modelet e qëndrueshme nuk duhet të fokusohen vetëm në objektivat e ngushta ekonomike, por kërkojnë të përcaktojnë vlera, interesa e objektiva që lidhen më rezultate ekonomike, sociale e mjedisore. Ato kërkojnë krijimin e vlerave të zgjeruara në kuptimin që të mos gjenerojnë vlera vetëm për një njësi, konsumatorët e grupet e saj të interesit, por të gjenerojnë vlera monetare e jomonetare për aktorë të tregut e jashtë tij (Bocken etj, 2013).
- *Të menduarit sistematik* – Modelet e biznesit janë sisteme të aktiviteteve të ndërlidhura, të cilat kërkojnë të menduarin sistematik nga sipërmarrësit. Kjo përfshin aspekte të ndryshme. Kështu duhet të merret në konsideratë cikli i jetës së produktit nëpërmjet aplikimit të koncepteve të tilla si skicimi ekologjik dhe prodhimi i pastër (Joyce&Paquin, 2016). Gjithashtu duhet të vlerësohet nëse vërtetë modeli i ri gjeneron vlerë të qëndrueshme për shumë aktorë apo grupe interesi (duke qenë se pikërisht ky është qëllimi i modeleve të qëndrueshme).
- *Shpesh kur flitet për qëllime të tjera përveç atij ekonomik atëherë mendohet se grupet e ndryshme të interesit kanë konflikt interesi. Kështu janë pronarët që duan fitimin, por nëse kërkohen dhe objektivat sociale e mjedisore, këto mund të kërkojnë shpenzime. Prandaj dhe në modelet e qëndrueshme është i*

rëndësishëm *integrimi i grupeve të interesit* (stakeholders) si një parim bazë orientues.

Sipas Evans etj (2017) identifikimi i lëvizjes së vlerave mes grupeve të interesit, duke përfshirë mjedisin natyror dhe shoqërinë si grupe primare interesi, mund të ofrojë mundësi të mëdha për inovacion në modelin e biznesit dhe ata propozojnë këndvështrimin e tyre të qëndrueshmërisë të paraqitur në figurën 2. Një model mund të përdoret mjaft mirë për të orientuar e qartësuar sipërmarrësin në përpjekjen e tij për të krijuar vlerë. Sipërmarrësit mund të zgjedhin disa prototipe modelesh biznesi për të bërë transformimin e biznesit e për t'i dhënë formë sipërmarrjes së tyre si dhe për të vlerësuar më mirë mundësitë (Bocken etj, 2013). Por kjo kërkon njohuri të konsiderueshme, prandaj më orientues mund të ishte një model i përshtatshëm biznesi. Modeli i biznesit Canvas (Osterwalder&Pigneur, 2010) është një mjet që mund ta ndihmojë mjaft mirë sipërmarrësin për të kuptuar elementet e ndryshëm e ndërlidhjet mes tyre për krijimin e vlerave. Por ky model kufizohet me qëllimin ekonomik.



Figurë 2. Qëndrueshmëria (Evans etj., 2017)

Duke kërkuar qëndrueshmërinë, mund të zgjerohemi te modeli i trefishtë Canvas (Joyce&Paquin, 2016), i cili merr parasysh të tre elementet e kërkuar nga qëndrueshmëria: vlerat ekonomike, mjedisore dhe sociale. Struktura e modelit orienton përdoruesin të kuptojë qartë dhe të drejtojë biznesin drejt qëndrueshmërisë, duke i shtuar shtresës ekonomike të modelit Canvas, edhe dy shtresat e tjera, shtresën sociale dhe të mjedisit. Ky model siguron një koherencë horizontale brenda çdo shtrese, por edhe koherencë vertikale pasi integron krijimin e vlerave mes tri shtresave.

Karakteristikat e fermave shqiptare

Struktura e fermave shqiptare është relativisht e thjeshtë duke mbajtur në konsideratë edhe madhësinë e tyre relativisht të vogël. Mbështetja ndaj bujqësisë në formën e

shërbimeve të vazhdueshme apo aksesit ndaj kredisë mbetet e ulët. Kjo kufizon së tepërmi prodhimin dhe konkurrueshmërinë e fermave shqiptare. Duke pasur parasysh kushtet shumë të favorshme klimaterike dhe fokusin e vazhdueshëm në sektor duhet të themi se shifrat e prodhimit bujqësor mbeten të ulta, ndërkohë që po të gjendeshin strategjitë e përshtatshme dhe modelet e përshtatshme të biznesit, këto ferma do rrisnin prodhimin, duke siguruar çmime të favorshme për produktet jetike për konsum, por nga ana tjetër të sigurojë prodhim për sektorin e agropërpunimit dhe pse jo të shtrihet edhe në eksport. Por diçka që duhet të konsiderojmë në nivel njësie e kombëtar është ndryshimi klimaterik, një nga arsytet pse insistohet aq shumë edhe me angazhimin për SDG-të. Sipas Sutton etj (2013) ndryshimet klimaterike do kenë një ndikim domethënës në prodhimin e perimeve dhe frutave, gjë që kërkon ndërhyrje në ferma për të përmirësuar kapacitetet e tyre aktuale prodhuese, pa cënuar prodhimin e ardhshëm. Integrimi i qëndrueshmërisë në fermë siguron mundësinë për ruajtjen e pjellorisë së tokës në afatgjatë nëpërmjet menaxhimit të kulturave, riciklimit të materieve organike si mbeturinat bimore e plehut të kafshëve, si dhe siguron mbrojtje nga sëmundjet, të gjitha këto çështje të ndjeshme për fermerin. Këto praktika do ruanin edhe token, si një burim shumë i rëndësishëm për të tashmen e të ardhmen.


Aplikimi i modelit të qëndrueshëm të biznesit në bujqësi

Ka mjaft modele që lidhin modelet e biznesit me bujqësinë dhe sektorin agro-ushqimor (Campbell etj, 2012; Vermeulen&Cotula, 2010) por modelet e përshtatshme varen nga specifikat e biznesit, vendit etj (FAO 2008, Vermeulen&Cotula, 2010). Këto modele biznesi për fermerët e vegjël dhe bizneset duhet të shpërndajnë shërbime bazë për prodhuesit dhe të sigurojnë besueshmëri me furnizimin të blerësit (FAO 2008). Një mundësi shumë e mirë për fermerët është vëmendja nga praktikatat e qëndrueshme në bujqësi. FAO (1995) përkufizon zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor si “menaxhimi dhe ruajtja e burimeve natyrore dhe orientimi i ndryshimeve teknologjike dhe institucionale në mënyrë të tillë që të sigurojnë plotësim të vazhdueshëm të nevojave të njerëzve për të tashmen dhe për brezat në vazhdim”. Qëndrueshmëria në bujqësi ka të njëjtat parime siç ato që përmendëm në modelet e qëndrueshme të biznesit: duhet të sjellë përfitim ekonomik, të mbrojë mjedisin natyror dhe të sigurojë mirëqënie sociale. Por, sidomos për vendet e zhvilluara dy faktorë të tjerë janë shumë të rëndësishëm: pjesëmarrja e bashkëpunimi dhe niveli i njohurive (Uziak&Lorencowicz, 2017; D’Souza etj, 1993). Nga ana tjetër studimet tregojnë që shkalla e zbatimit të qëndrueshmërisë në bujqësi në vendet e zhvilluara është shumë e ulët dhe duket se kjo varet nga fakti i thjeshtë se në këto vende nuk plotësohen nevojat për ushqim dhe që sigurisht ky është një kusht i domosdoshëm për t’u zhvendosur drejt praktikave të qëndrueshme (Andersson&D’Souza, 2014; Adenle etj, 2017; Thierfelder etj, 2014; Erenstein etj, 2012). Prandaj dhe është thelbësore që, që në fazën e planifikimit, të

bëhet një vlerësim i praktikave për të analizuar nëse praktikimi i sistemit të qëndrueshmërisë përmirëson prodhimin e ushqimit për të kënaqur së pari nevojat për konsum të fermerit e familjes së tij. Sipas Munthali etj (2012) pjesa më e madhe e përpjekjeve për qëndrueshmëri në bujqësi në vendet e zhvilluara financohen nga donatorë dhe nuk kanë mekanizma për të mbijetuar pasi mbarojnë projektet. Aktivitetet e pjesës më të madhe të projekteve kufizohen në plotësimin e nevojave ekzistenciale dhe nuk promovojnë sigurimin e inputeve bazë bujqësore. Përdorimi i një modeli konkret biznesi do qartësonte fermerin dhe do e ndihmonte në orientimin për të bërë fermën më të vlefshme nga ana ekonomike dhe me këndvështrimin afatgjatë të qëndrueshmërisë. Duke iu referuar modelit të trefishtë Canvas (Joyce&Paquin, 2016) realizohet një përshtatje për përdorim nga fermeri (figura 4).

Po sikur në Shqipëri?

Është e rëndësishme që fermerët të shfrytëzojnë në maksimum potencialet e tyre. Rritja e prodhimit bujqësor ndihmon jo vetëm ekonominë e elementet e saj, por krijon mundësinë e uljes së çmimeve jetike që konsumohen nga popullsia dhe ndikon edhe në bilancin tregtar të vendit, duke zvogëluar varësinë nga importet (INSTAT, 2020). Modelet efektive të biznesit ndihmojnë fermerët të rrisin efikasitetin në zinxhirin e furnizimit por kjo rrallë ndodh në mënyrë spontane, duke pasur parasysh marrëdhëniet kundërshtarë që karakterizojnë rrjetin tregtar në sektorin agro-ushqimor, prandaj dhe është e rëndësishme të qartësohen e të zhvillohen plane (FAO, 2008).



Figurë 3. Faktorët e bujqësisë së qëndrueshme (Uziak&Lorencowicz, 2017)

Shtresa mjedisore e modelit të trefishtë Canvas

Furnitorët	Prodhimi	Vlera funksionale	Fundi i jetës	Faza e Përdorimit
Kujdes në fara Fertilizues natyror	Rotacion kulturash Përqaftim i diversitetit Zvogëlim/eliminim i lërimit të tokës Integrim bujqësi e blegtori	Produkte bio Larmi produktesh	Rigjenerim i tokës nëpërmjet rotacionit Fertilizues natyrorë	Produkte të freskëta, organike, të shëndetshme
	Materialet Vetë-rregulluese		Shpërndarja Kanale formale të shpërndarjes Bashkëpunim me markete	
Ndikimi mjedisor Ndikim minimal		Përfitimi mjedisor Fertilizues natyror Favorizon qarkullimin		

Shtresa sociale e modelit të

trefishte te Canvasit

Komuniteti	Qeverisja	Vlera sociale	Vlera Kulturore	Përdorues Përfundimtar
Local	Fermë e Vetëqeverisur	Promocion i vendit	Ruajtja e kulturave e zhvillim kulturash të reja	Kënaqësi
Ferma të suksesshme Komuniteti i zhvilluar		Zhvillim ferma turistike ose ferma për fëmijë		Shije
	Punonjësit		Identifikimi nga kons.	Shëndet
	Ferma të suksesshme rritje punësimi		Vizitore në fermat turistike e për Fëmijë	
Ndikimi social		Përfitimi social		
Nuk ka ndikim negativ në komunitet		Më tepër mundësi për fermerët	Përmirësim i cilësisë së jetës së komunitetit	

Shtresa ekonomike e modelit të trefishtë Canvas

Partnerët	Aktivitetet	Krijimi i vlerave	Marrëdhënia me kons.	Segmentet e kons.
Vetë-rregulluese për farat	Prodhim Shërbim për fermat turistike e për fëmijë	Produkte/shërbime cilësor	Kanale formale	Familje
e fertilizuesit		Rotacion kulturash	Media sociale	Turistë vendas e të huaj
	Burimet	Përqafim i diversitetit		Kopshte/shkolla
	Të vetat	Zvogëlim/eliminim i lërimit të tokës	Kanalet	
		Integrim bujqësi e blegtori	Media sociale	
			Media lokale	
Kosto			Të ardhura	
Prodhim	Promocion	Kanale shpërndarje	Produkti	Shërbimi

Figura 4. Modeli i trefishtë Canvas (Joyce&Paquin, 2016), përshtatje për Bujqësinë

Fermerët e vegjël në zonat rurale përgjithësisht janë më të shqetësuar për çështje praktike si pajisjet bujqësore e aktiviteti për të siguruar prodhim, ndërsa shqetësimi për çështje ekologjike e sociale është minimal apo as nuk ekziston fare. Niveli i njohurive që është i lidhur direkt me nivelin e edukimit, është një faktor vendimtar pasi teknika të tilla si sisteme të zhvilluara të vaditjes, teknologji për administrimin e kombinuar të dëmtuesve, zvogëlimin e konsumimit të fertilizuesve kimikë e

zhvendosjes drejt konsumit të fertilizuesve organikë dhe mbështetja e variacionit biologjik mund të arrihet vetëm me nivel të lartë të njohurive (Uziak&Lorencowicz, 2017). Njohuritë janë të rëndësishme pasi mund të bëjnë fermerët të kuptojnë, të ndërgjegjësohen, të reagojnë për të kuptuar e aplikuar zgjidhjet e duhura në bujqësi. Por nga ana tjetër edhe pjesëmarrja e bashkëpunimi janë thelbësore, madje këto mund të jenë faktorë kyç për të siguruar njohuritë. Dëshira e fermerëve për t'u përfshirë në trajnime e programe që paraqesin zgjidhje të përshtatshme për të rritur eficientësinë e fermave të tyre mund të shfrytëzohet për të përhapur praktikën e qëndrueshmërisë në bujqësi. Prandaj dhe është e nevojshme ndihma e sektorit publik për të inkurajuar sektorin dhe ndërlidhjen e aktorëve në zinxhirin e furnizimit (FAO, 2008; Tambunan etj, 2013), por edhe për t'u siguruar që politikën lehtësojnë kostot e pengesat për të bërë biznes me fermerët e vegjël (FAO, 2012). Nuk duhet të harrohet rëndësia e qeverisë për të theksuar rëndësinë e sektorit në masterplanin për vendin dhe për të stimuluar zhvillimin e tij. Duke qenë se Shqipëria është në procesin e integritit, përmirësimi i sektorit të bujqësisë është një domosdoshmëri për të prodhuar produkte më të mira si për tregun e brendshëm, por jo edhe për të konkurruar në tregun ndërkombëtar. Prandaj dhe ndërhyrja nëpërmjet programeve të informimit, ndërgjegjësimit e mësimit të praktikave të mira mes fermerëve, do ishte një element i domosdoshëm. Të kemi parasysh që fermerët e vegjël me një mesatare toke 0.5ha përbëjnë 74% të totalit të fermerëve (FAO, 2016) dhe domosdoshmëria e tyre për të plotësuar së pari nevojat familjare është primare. Hapi tjetër është mundësia për të shitur pjesën e mbetur në treg. T'i përmendësh këtij fermeri elementin ekologjik, ndërkohë që përpiqet të ushqejë familjen e tij, është një argument jo fort bindës. Prandaj dhe ekziston nevoja është për nxitës ekonomikë nga politikë-bërësit (Uziak&Lorencowicz, 2017). Gjithashtu është një nevojë imediate edukimi dhe përmirësimi i ndërgjegjësimit dhe vullnetit të fermerëve për t'u përfshirë, gjë që mund të arrihet nëpërmjet shërbimeve të zgjeruara apo trajnimeve të komunitetit. Duke qenë se zgjidhjet afatgjata kërkojnë që qëndrueshmëria të bazohet në nevojat e fermerëve dhe plotësimin e pritshmërive të tyre, theksi duhet të vendoset në sigurimin e mjeteve e teknikave për fermerët që të përmirësojnë kushtet e tyre ekonomike. Një problem i madh për vendin tonë vazhdon të jetë migrimi nga zonat rurale. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë në këto zona braktisin vendin për t'u shpërngulur në qytet ose edhe më tej. Por aplikimi i praktikave të suksesshme të bujqësisë së qëndrueshme do përmirësonte cilësinë e jetës në zonat rurale dhe do ishte motivues për fermerët për të shfrytëzuar burimet që kanë në dispozicion në mënyrë të qëndrueshme. Duke iu referuar modelit të trefishtë Canvas (figura 4), pasja e një modeli e bën konceptin më të thjeshtë për t'u kuptuar dhe për t'u aplikuar. Siç shihet edhe nga modeli, fermeri mund të zgjerojë aktivitetet që kryen në fermë. Përveç prodhimit të produkteve bujqësore, ai mund të ofrojë edhe shërbimin e një ferme turistike apo për fëmijë. Kjo e fundit do ndikonte në edukimin e marrëdhënies me pronën dhe me tokën që në vogëli,

gjë që duke e konsideruar si një investim për shoqërinë, mund të shihet edhe mundësia e subvencionimit nga qeveria (Torquati etj, 2015).

Rezultate

Bujqësia mbetet një sektor strategjik në ekonominë shqiptare, e suportuar me strategji të ndryshme ndër vite. Megjithatë sektori bujqësor nuk ka pasur një trend pozitiv duke pasur në vitin 2019 rritjen më të ulët vjetore të 6 viteve të fundit (INSTAT, 2020). Angazhimi i Shqipërisë për realizimin e SDG-ve dhe bujqësia e integruar në shumicën e këtyre objektivave e bën të domosdoshme ndërhyrjen në nivel makro nëpërmjet strategjive e politikave, por edhe në nivel ferme. Aplikimi i qëndrueshmërisë në nivel ferme është krejtësisht i arritshëm (Uziak&Lorencowicz, 2017) duke siguruar edhe mundësinë e lehtësimit të varësisë nga importet (INSTAT, 2020). Ofrimi i një modeli (Joyce&Paquin, 2016) do e bënte më të thjeshtë konceptin pa qenë e nevojshme të arrihet një nivel i lartë njohurish për aplikim (Uziak&Lorencowicz, 2017). Përfshirja e konceptit të qëndrueshmërisë në fermë do siguronte një produktivitet më të lartë nëpërmjet rritjes së pjellorisë së tokës dhe integritit të bujqësisë me blegtorinë sidomos në rastet e fermave mikse.

Konkluzione dhe diskutime

Qëndrueshmëria është një koncept që kërkon një zhvendosje në mënyrën sesi bëhet biznes. Në kushtet kur nevojat ekonomike të fermerëve nuk plotësohen është e vështirë që ata të gjejnë stimul tek qëllimi social apo mjedisor. Prandaj dhe duhet të kërkohej mbështetja tek bashkëpunimi dhe njohuritë (Uziak&Lorencowicz, 2017). Është e nevojshme të punohet për kapitalin njerëzor në mënyrë që fermerët të zbatojnë praktikën e qëndrueshmërisë dhe të përmirësojnë nivelin e jetesës së tyre dhe atë të komunitetit përreth. Të ardhurat nga të korrat përbëjnë 20% të të ardhurave të fermerëve të vegjël (FAO 2016), të ardhura që kryesisht krijohen nga shitja në tregjet informale. Këto tregues paraqesin një problematikë të sektorit bujqësor pavarësisht se ky është një sektor i rëndësishëm e kyç për ekonominë tonë. Duke pasur një klimë të favorshme gjatë gjithë vitit, praktika të tilla si rotacioni i të mbjellave, ulja apo eliminimi i lërimit të tokës, mospërdorimi apo ulja e përdorimit të kimikateve, integrimi i të mbjellave me gjënë e gjallë etj, do nxisnin prodhimin bujqësor dhe kjo do ishte:

- ✓ një nxitje *ekonomike* për fermerin (vetëm 12% e prodhimit bujqësor shitet në treg – FAO 2018) por
- ✓ do kishte efekt *social* (duke krijuar vende pune e përmirësim të cilësisë së jetës në zonat rurale) si dhe
- ✓ efekt *mjedisor* (praktika që do përdornin më së miri këtë burim kaq me vlerë si toka, duke siguruar prodhimin e tashëm pa cënuar prodhimin në të ardhmen).

Ky artikull është një kontribut i vlefshëm për fermerët shqiptarë. Identifikimi i lëvizjes së vlerave mes grupeve të interesit ofron mundësi të shumta (Evans etj, 2017). Ofrohen shumë modele që lidhin modelin e biznesit me bujqësinë dhe sektorin agroushqimor (Campbell etj, 2012; Vermeulen&Cotula, 2010), por paraqitja e një modeli e bën konceptin më të thjeshtë për t'u kuptuar e për t'u zbatuar dhe modeli i trefishtë Canvas (Joyce&Paquin, 2016) mund të shërbejë si një model shumë i mirë edhe në bujqësi. Përfshirja e qëndrueshmërisë në fermat shqiptare do sigurojë një reagim pozitiv ndaj ndryshimeve klimaterike (Sutton etj, 2013), një kërkesë e domosdoshme që po shtrohet në plan ndërkombëtar, por për zbatim nga secili nga ne. Nëpërmjet implementimit të modelit të qëndrueshëm (shih figurën 4) mund vlerësohet edhe mundësia e zgjerimit të aktiviteteve të fermave. Shqipëria ka modele fermash turistike, por nga ana tjetër janë edhe fermat për fëmijë, të cilat duke u konsideruar si një investim për edukimin e brezave (Uziak&Lorencowicz, 2017) mund të vlerësohen për programe subvencionimi nga politikëbërësit. Implementimi i modelit në një rast konkret studimi mund të bëhet objekt i studimeve të ardhshme.

Referencat

- Adenle, A.A., Azadi, H. & Manning, L. (2017). The era of sustainable agricultural development in Africa: Understanding the benefits and constraints. *Food Reviews International*, DOI: 10.1080/87559129.2017.1300913
- Andersson, J.A., D'Souza, S. (2014). From adoption claims to understanding farmers and contexts: A literature review of Conservation Agriculture adoption among smallholder farmers in southern Africa. *Agriculture, Ecosystems and Environment*, 187, 116-132
- Baden-Fuller, Ch., Haeffliger S. (2013). Business Models and Technological Innovation, *Long Range Planning*, Dhjetor
- Baden-Fuller, Ch., Morgan, M. (2010). Business models as models. *Long Range Planning*, 43 (2-3), 156-171
- Bessant, J., Tidd, J. (2018). *Innovation and Entrepreneurship*, bot.3, reprinted, Wiley, ISBN 978 1118 993095
- Bocken, N., Short, S., Padmakshi, R., Evans, S. (2013). A value mapping tool for sustainable business modelling: Corporate Governance. *The International Journal of Business in Society*, 13 (5), 482-497
- Breuer, H., Luedeke-Freund, F., Fichter, K., Tiemann, I. (2013). Sustainability-oriented Business model development: Principles, criteria and tools. *International Journal of Entrepreneurial Venturing*, DOI: 10.1504/IJEV.2018.10013801
- Campbell, R., Knowles, T., Sayasenh, A. (2012). *Business Model for Foreign Investment in Agriculture in Laos*, published by ISSD

- Chesbrough, H. (2010). Business Models innovation: opportunities and barriers. *Long Range Planning*, 43 (2-3), 354-363
- Csik, M., Gassmann, O., Frankenberger, K. (2013). *The St. Gallen Business Model Navigator*, i disponueshëm në <https://www.thegeniusworks.com/wp-content/uploads/2017/06/St-Gallen-Business-Model-Innovation-Paper.pdf>
- Demil, B., Lecocq, X. (2010) Business Model Evaluation: In search of dynamic consistency. *Long Range Planing* 43, 227-246, DOI: [10.1016/j.lrp.2010.02.004](https://doi.org/10.1016/j.lrp.2010.02.004)
- Dionizi, B., Kërcini, D. (2015). Thinking Strategically in Agribusiness, Case of Albania”, QUAESTI, Virtual Multidisciplinary International Conference, Slovakia, research paper
- Dionizi, B., Kërcini, D. (2021). Pse Shqipëria duhet të konsiderojë qëndrueshmërinë në bujqësi, e disponueshme në <https://ubgreen.al/pse-shqip%20ria-duhet-t%20ndryshoj%20q%20ndrueshm%20rin%20n%20d%20si/>
- D.Souza, G., Cyphers, D., Phipps, T. (1993). Factors affecting the adoption of sustainable agriculture in the North-Central Region. *Agriculture and Human Values*, 17 (4), 347-358
- Erenstein, O., Sayre, K., Wall, P., Hellin, J., Dixon, J. (2012). Conservation Agriculture in Maize-and wheat-based systems in the (sub)tropics: Lessons from adaption initiatives in South Asia, Mexico and Southern Africa. *Journal of Sustainable Agriculture*, 36, 180-206
- Evans, S., Vladimirova, D., Holgado, M., Van Fossen, K., Yang, M., Silva, E., Barlow, C. (2017). Business Model innovation for sustainability: Towards a unified perspective for creation of sustainable business models. *Business Strategy and the Environment*, 26, 597-608
- FAO, 2008, Business Models for Small Farmers and SMEs
- FAO (1995). Sustainable Agriculture and Rural Development. në T. Loftas (ed.), *Dimensions of need - An atlas of Food and Agriculture*
- FAO (2012) Smallholder business models for agribusiness-led development, e disponueshme në <https://www.fao.org/sustainable-food-value-chains/library/details/en/c/266537/>
- FAO (2016) Small farms Country Fact Sheet, Albania, e disponueshme në <https://www.fao.org/family-farming/detail/en/c/1128088/>
- FAO (2018) e disponueshme në <http://www.fao.org/faostat/en/#country/3>
- FAO (2018) Factsheet for Albania, e disponueshme në <http://www.fao.org/family-farming/detail/en/c/1128088/>

- Gassman, O., Frankenberger, K., Csik, M. (2013) *Innovation of business model*, Hanser (ed)
- INSTAT, 2019, Llogaritë kombëtare e disponueshme në <http://www.instat.gov.al/al/temat/ekonomi-dhe-financ%C3%AB/llogarit%C3%AB-komb%C3%ABtare-gdp/#tab2>
- INSTAT, 2020, statistika të disponueshme në <http://www.instat.gov.al/media/7200/njoftim-p%C3%ABr-media-statistikat-e-bujq%C3%ABsis%C3%AB-p%C3%ABr-vitin-2019.pdf>
- INSTAT, 2020, statistika të disponueshme në <http://www.instat.gov.al/al/temat/bujq%C3%ABsia-dhe-peshkimi/bujq%C3%ABsia/publikimet/2020/statistikat-e-bujq%C3%ABsis%C3%AB-2019/>
- INSTAT, 2020, statistika import/eksport produkte bujqësore, të disponueshme në <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregtia-e-jashtme/tregtia-e-jashtme-e-mallrave/#tab2>
- Joyce, A., Paquin, R. L. (2016). The triple layered business model canvas: a tool to design more sustainable business models. *Journal of Cleaner Production*, 135, 1474-1486
- Lecocq, X., Demil, B. (2010). Business Models as a research program in strategic management. *Management*, 13 (4), 214-225
- Munthali, S., Mkandawire, R. M., Tembo, N. (2012). Sustainable Agriculture: A Panacea for Achieving Biodiversity Conservation and Rural Development in Sub-Saharan Africa?, doi: [10.5772/29004](https://doi.org/10.5772/29004)
- Osterwalder, A. (2004). The Business Model Ontology – A proposition in a Design Science Approach (Doctoral Thesis), University of Lausanne, Lausanne, Switzerland
- Osterwalder, A., Pigneur, Y. (2010), *Business Model Generation: A Handbook for visionaries, game changers and challengers*. Wiley, New Jersey
- Sinfield, J.V., Calder, E., McConnell, B., Colson, S. (2012). How to identify new business models. *MIT Sloan Management Review*, 53 (2), 84-92
- Sutton, W.R. Srivastava, J.P. Neumann J.E. Strzepek, K.M. (2013) Reducing the vulnerability of Albanias agricultural systems to climate change, <https://doi.org/10.1596/978-1-4648-0047-4>
- Tambunan, T.T.H. (2013) A survey of business models for agricultural investments in Indonesia, International Institute for Sustainable Development (ed)
- Teece D.J. (2010) Business models, business strategy and innovation. *Long Range Plan*, 43 (2-3), 172-194

- Thierfelder, C. Rusinahodzi, L. Ngwira, A.R., Mupangwa, W., Nyagumbo, I., Kassie G.T., Cairns, J.E. (2014), Conservation agriculture in Southern Africa: Advances in knowledge. Renewable Agriculture and Food Systems, *Cambridge University Press*. 1-21 doi:10.1017/S1742170513000550
- Torquati, B., Tancini, C., Paffarini, Ch., Illuminati R. (2013). Empirical survey on business models for kindergarten farms, *Agricultural and Food Economics, Springer Open Journal*, <https://doi.org/10.1186/s40100-015-0043-4>
- Uziak, J., Lorencowicz, E. (2017). Sustainable agriculture-developing countries perspective, IX International Scientific Symposium, Farm Machinery and Processes Management in Sustainable Agriculture, Lublin, Poland
- Vermeulen, S., Cotula, L. (2010). *Making the most of Agricultural Investment: A survey of business models that provide opportunities for smallholders*, IIED/FAO/IFAD/SDC, London/Rome/Bern, ISBN: 978-1-84369-774-9
- Weber, C., Kratzer, J. (2013). Social entrepreneurship, social networks and social value creation: a quantitative analysis among social entrepreneurs. *International Journal of Entrepreneurial Venturing*, 5 (3), 217-221
- Wells, P. (2016). Economies of Scale versus small is beautiful: A business model approach based on architecture, Principles and components in the beer industry. *Organization & Environment*, 29 (1), 36-52
- <https://bujqesia.gov.al/objektivat-e-zhvillimit-te-qendrueshem-ne-bujqesi-ekonomi-angazhim-maksimal-per-te-realizuar-objektivat-e-sdgs/>